



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.\_\_.2021

**VENDIM**  
**Nr. 260, datë 17.06.2021**

**PËR**  
**PËRSËRITJEN E TRANSFERIMIT TË PËRKOHSHËM TË GJYQTARES**  
**{...} NË GJYKATËN ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË DURRËS**

Këshilli i Lartë Gjyqësor mbështetur në nenin 46 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në vendimin nr. 23, datë 07.02.2019 të KLGJ-së “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit” i ndryshuar, në vendimet nr. 98, datë 21.06.2019, nr.194, datë 04.06.2020 dhe nr.203 datë 11.06.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe duke mbajtur në konsiderate dhënien e pëlqimit të gjyqtares {...} me shkresën nr. 2628 prot., datë 04.06.2021, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës,

**VENDOSI:**

1. Gjyqtares {...}, aktualisht gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, i përsëritet transferimi i përkohshëm, në Gjykatën në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës, për një periudhë deri në 1 (një) vit, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
2. Efektet e këtij vendimi fillojnë nga data 22.06.2021.
3. Njoftimin e këtij vendimi gjyqtares znj. {...}, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**